

20100500925

L I G J PËR MBIKËQYRJE INSPEKTUESE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e Ligjit

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohen parimet themelore të mbikëqyrjes inspektuese, organizimi i shërbimeve inspektuese, koordinimi i shërbimeve inspektuese, të drejtat dhe detyrimet e inspektorëve, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të mbikëqyrjes, procedura për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese dhe çështje tjera të cilat kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese.

(2) Dispozitat e këtij ligji u dedikohen inspektorëve në shërbimet inspektuese, të cilat janë të organizuara si organe në përbërje të ministrive (në tekstin e mëtejshëm: inspektorate), ose si njësi organizative në suaza të organeve tjera të administratës shtetërore dhe njësite të vetadministrimit lokal dhe të qytetit të Shkupit.

Domethënia e shprehjeve të përdorura në këtë ligj

Neni 2

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë domethënien si vijojnë:

1. **Shërbimet inspektuese** janë inspektoratet, njësitë organizative në suaza të organeve të administratës shtetërore dhe njësitë organizative në suaza të njësite të vetadministrimit lokal dhe të qytetit të Shkupit, të cilat kanë kompetenca inspektuese;

2. **Mbikëqyrja inspektuese** është mbikëqyrje mbi zbatimin e ligjeve dhe rregullave të miratuara në bazë të ligjit në punën e organeve shtetërore, njësitë e vetadministrimit lokal dhe qytetit të Shkupit, ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare, institucionet dhe personat fizikë dhe juridikë mbi të cilët kryhet mbikëqyrja, si dhe shqiptimi i masave dhe sanksioneve inspektuese me qëllim të mënjanimit të parregullsive të konstatuara;

3. **Procedura inspektuese** është lloj i veçantë i procedurës, i rregulluar me këtë ligj, me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative ose me ligj tjetër, i cili e rregullon veprimin e inspektorëve gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese;

4. **Aktet inspektuese** janë të gjitha ato akte dhe veprime të cilat inspektorët i miratojnë dhe i ndërmarrin në procedurën inspektuese;

5. **Inspektor** është personi zyrtar me autorizime dhe përgjegjësi të posaçme të përcaktuara me ligj, i cili kryen mbikëqyrje inspektuese;

6. **Subjekt i mbikëqyrjes** janë organet shtetërore, organet e njësisë së vetadministrimit lokal dhe të qytetit të Shkupit, ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare, institucionet, fondacionet dhe shoqatat e qytetarëve, personat fizikë dhe juridikë mbi të cilët kryhet mbikëqyrje dhe

7. **Masat inspektuese** janë sanksione dhe masa administrative të parapara me këtë dhe me ligj tjetër, të cilat i shqiptojnë inspektorët gjatë mbikëqyrjes inspektuese për mënjanimin e parregullsive të konstatuara.

II. PARIMET THEMELORE TË MBIKËQYRJES INSPEKTUESE

Parimi i ligjshmërisë

Neni 3

Në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori është i obliguar që të veprojë në pajtueshmëri me Kushtetutën, ligjet, marrëveshjet e ratifikuara

Mbrojtja e interesit publik

Neni 4

(1) Inspektori e kryen mbikëqyrjen inspektuese me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së interesit publik, si dhe interesit të personave fizikë dhe juridikë, kur kjo është në pajtueshmëri me interesin publik.

(2) Procedura për mbikëqyrje inspektuese fillon dhe udhëhiqet me detyrë zyrtare.

(3) Secili mund të parashtrijë iniciativë për ngritje të procedurës për mbikëqyrje inspektuese.

Parimi i barazisë, paanshmërisë dhe objektivitetit

Neni 5

(1) Inspektori në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese është i obliguar që të sigurojë zbatim të njëjlojtë, ligjor, të paanshëm dhe objektiv të ligjeve dhe dispozitave tjera.

(2) Inspektori në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese është i obliguar që punët t'i kryejë me vetëdije, profesionalisht, në mënyrë efikase, me rregull, me kohë, dhe në mënyrë të paanshme.

Parimi i të vërtetës materiale

Neni 6

(1) Inspektori me detyrë zyrtare e përcakton gjendjen faktike dhe nxjerr fakte në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Subjekti i mbikëqyrjes, gjatë kohës së procedurës së mbikëqyrjes inspektuese mund të propozojë dhe të paraqesë fakte të cilat janë me rëndësi për përcaktimin e plotë të gjendjes faktike.

Parimi i dëgjimit të subjekteve të mbikëqyrjes

Neni 7

Para ndërmarrjes së masave inspektuese për mënjanimin e mangësive të konstatuara te subjektet e mbikëqyrjes, inspektori është i obliguar që t'u japë mundësi subjekteve të mbikëqyrjes, të deklarohen për faktet dhe rrethanat të cilat konstatohen gjatë mbikëqyrjes inspektuese.

Parimi i pavarësisë

Neni 8

(1) Inspektori është i pavarur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese dhe vendosjes për veprime të cilat duhet të ndërmerren gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, si dhe për masat të cilat do të shqiptohen pas mbikëqyrjes së kryer.

(2) Inspektori kryen mbikëqyrje inspektuese në pajtueshmëri me planin mujor ose sipas urdhëresës me shkrim të ministrit, drejtorit dhe funksionarit i cili udhëheq organin e administratës shtetërore, përkatësisht kryetarit të komunës.

(3) Për shkak të madhësisë ose ndërlikueshmërisë, mbikëqyrje inspektuese mund të kryejnë më shumë inspektorë.

(4) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga më shumë inspektorë përpilohet një procesverbal dhe miratohet një akt inspektues, të cilët nënshkruhen nga të gjithë inspektorët të cilët kanë marrë pjesë në mbikëqyrje.

Parimi i publicitetit

Neni 9

(1) Mbikëqyrja inspektuese është publike.

(2) Shërbimet inspektuese në kuadër të autorizimeve të tyre të përcaktuara me ligj, rregullisht e informojnë publikun për punën e tyre.

(3) Shërbimet inspektuese janë të obliguara që ta informojnë publikun për gjendjet e konstatuara dhe parregullsitë të subjektet e mbikëqyrjes, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, si dhe për masat e ndërmarra inspektuese, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, pronës ose për shkak të shkeljeve të rënda të interesit publik.

Parimi i proporcionalitetit

Neni 10

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori i ndërmerr vetëm ato masa inspektuese në pajtim me ligjin, të cilat janë të domosdoshme për mënjanimin e mangësive të konstatuara gjatë mbikëqyrjes së kryer, me ç'rast kihet kujdes i veçantë që të mos pengohet funksionimi efikas i subjektit të mbikëqyrjes.

(2) Gjatë përcaktimit të masave inspektuese dhe të afateve për mënjanimin e mangësive të konstatuara, inspektori udhëhiqet nga peshat e mangësisë, pasojat e dëmshme të shkaktuara ndaj interesit publik ose ndaj interesit të personave të tretë, si dhe koha e cila është e nevojshme që subjekti i mbikëqyrjes t'i mënjanojë mangësitë e konstatuara.

Parimi i preventivës

Neni 11

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori së pari kryen funksion preventiv, kurse shqipton masa dhe sanksione inspektuese atëherë kur me funksionin preventiv nuk mund të sigurohet qëllimi i mbikëqyrjes.

Parimi i subsidiaritetit

Neni 12

(1) Në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj ose me ligj tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

(2) Çështje të caktuara në lidhje me mbikëqyrjen inspektuese, mund të rregullohen me ligje të veçanta.

III. SHËRBIMET INSPEKTUESE

Organizimi i shërbimeve inspektuese

Neni 13

(1) Inspektori punët e mbikëqyrjes inspektuese i kryen në kuadër të shërbimeve inspektuese, të cilat janë të formuara për sfera të caktuara administrative.

(2) Shërbimet inspektuese organizohen si inspektorate, ose si njësi organizative në kuadër të organeve tjera të administratës shtetërore, ose në kuadër të njësive të vetadministrimit lokal dhe qytetit të Shkupit.

Udhëheqja e organeve inspektuese

Neni 14

(1) Inspektoratin e udhëheq drejtori i inspektoratit (në tekstin e mëtejshëm: drejtori), të cilin e emëron dhe e shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në pajtueshmëri me ligjin.

(2) Me shërbime inspektuese të organizuara si njësi organizative në kuadër të organeve tjera të administratës shtetërore, ose në kuadër të njësive të vetadministrimit lokal dhe qytetit të Shkupit, udhëheq nëpunës titulli i të cilit i përgjigjet formës organizative të shërbimit inspektues të përcaktuar me ligj.

Të drejtat dhe obligimet e funksionarit i cili udhëheq me inspektoratin

Neni 15

(1) Drejtori miraton program vjetor për punën e inspektoratit dhe përgatit plane mujore për punën e inspektoratit.

(2) Drejtori dorëzon raport vjetor në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për punën e inspektoratit për vitin paraprak, më së voni deri më 31 mars të vitit rrjedhës.

(3) Për shërbimet inspektuese të organizuara si njësi organizative në kuadër të organeve tjera të administratës shtetërore, ose në kuadër të njësive të vetadministrimit lokal dhe qytetit të Shkupit, funksionari i organit të administratës shtetërore, përkatësisht kryetari i komunës i ka të drejtat dhe obligimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

Këshilli Inspektues

Neni 16

(1) Për shkak të koordinimit të ndërsjellë dhe efikasitetit më të madh të shërbimeve inspektuese formohet Këshill Inspektues, si trup i përhershëm ndërmjet resorëve.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë e përcakton koordinatorin e Këshillit Inspektues.

(3) Anëtarë të Këshillit Inspektues janë drejtorët e inspektorateve dhe funksionarët e organeve të administratës shtetërore të cilët kanë kompetenca inspektuese.

(4) Për çështje të caktuara në kompetencë të vet, Këshilli Inspektues në punën e vet, mund të përfshijë edhe përfaqësues nga shërbime tjera inspektuese edhe nga njësitë e vetadministrimit lokal dhe qyteti i Shkupit, përfaqësues nga publiku shkencor dhe profesional dhe përfaqësues nga shoqata dhe fondacione.

(5) Fushëveprimi i punës së Këshillit Inspektues është koordinimi i punës së shërbimeve inspektuese, shqyrtimi i çështjeve në lidhje me punën e shërbimeve inspektuese dhe aftësimi dhe përsosja profesionale e inspektorëve, si dhe zbatimi i ligjeve dhe dispozitave tjera të cilat kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese.

(6) Këshilli Inspektues për punën e tij miraton rregullore pune.

(7) Këshilli Inspektues për punën e tij e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dy herë në vit dhe sipas nevojës.

(8) Për shkak të realizimit të funksionit të koordinimit, Këshilli Inspektues mund të kërkojë nga shërbimet inspektuese që t'i dorëzojnë informata dhe raporte periodike për punën e tyre.

(9) Raportin vjetor nga neni 15 paragrafi (2) i këtij ligji, drejtori e dorëzon edhe te Këshilli Inspektues.

(10) Punët administrative-profesionale për Këshillin Inspektues, i kryen Inspektorati Administrativ Shtetëror-organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë.

Evidenca dhe statistika inspektuese

Neni 17

(1) Shërbimet inspektuese për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese janë të obliguar që të mbajnë evidencë të veçantë për të dhënat të cilat kanë të bëjnë me procedurën inspektuese (në tekstin e mëtejme: evidencë inspektuese).

(2) Shërbimet inspektuese për të dhënat të cilat kanë të bëjnë me statistikën inspektuese, janë të obliguara që të dorëzojnë raporte në çdo gjashtë muaj në Këshillin Inspektues.

(3) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së evidencës inspektuese nga paragrafi (1) i këtij ligji, si dhe përmbajtjen e statistikës inspektuese nga paragrafi (2) i këtij neni, i përcakton ministri i Drejtësisë.

IV. STATUSI I INSPEKTORËVE

Kushtet për kryerjen e detyrës së inspektorit

Neni 18

(1) Inspektor mund të bëhet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për nëpunës shtetërorë ose me ligj tjetër, dhe kushtet e veçanta të përcaktuara me ligj dhe me Aktin për sistematizim të vendeve të punës në shërbimin inspektues.

(2) Inspektori është i obliguar që ta japë provimin profesional për inspektor në afat prej një viti, por jo edhe para kalimit të gjashtë muajve nga dita e themelimit të marrëdhënies së punës.

(3) Nëse inspektori nuk e jep provimin nga paragrafi (2) i këtij neni në afat prej tre muajsh nga dita e dhënies së provimit, ka të drejtë për dhënie të përsëritur të të njëjtit.

(4) Inspektorit i cili gjatë dhënies së përsëritur të provimit nuk e jep provimin nga paragrafi (2) i këtij neni, marrëdhënia e punës i ndërpritet.

(5) Inspektori ka të drejtë dhe obligim që profesionalisht të aftësohet për kryerjen e punëve të tij dhe detyrave të punës, në pajtueshmëri me programin vjetor për trajnim të specializuar në sferën e mbikëqyrjes inspektuese.

(6) Programin vjetor për trajnim të specializuar në sferën e mbikëqyrjes inspektuese me propozim të drejtorit të inspektoratit e miraton ministri, përkatësisht funksionari i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, përkatësisht kryetari i komunës, më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës, për vitin e ardhshëm.

(7) Inspektori i cili gjatë kryerjes së punëve i është ekspozuar rrezikut të lartë për jetën dhe shëndetin e tij, ka të drejtë në shtesë të rrogës, varësisht nga lloji i rrezikut në lartësi prej 10-30% nga shuma e rrogës bazë dhe shtesës së rrogës për titull.

(8) Vendet e punës nga paragrafi (7) i këtij neni, i përcakton Agjencia për Nëpunës Shtetërorë.

(9) Lartësinë e shumës nga paragrafi (7) i këtij neni, e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Provimi profesional për inspektor

Neni 19

(1) Provimi profesional realizohet për vlerësimin e njohurive të nevojshme profesionale, për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës së inspektorit.

(2) Provimi profesional realizohet përmes dhënies së provimit në pajtueshmëri me programin për provim profesional për inspektor, që me propozim të drejtorit të inspektoratit e miraton ministri, përkatësisht funksionari i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, përkatësisht kryetari i komunës.

(3) Me provimin vërtetohet nëse inspektori posedon njohuri profesionale për kryerje të pavarur të mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Provimi profesional përbëhet prej pjesës me shkrim dhe me gojë, në pajtueshmëri me programin nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Provimi profesional realizohet dy herë gjatë vitit kalendarik.

(6) Mënyrën e dhënies së provimit profesional, e përcakton ministri i Drejtësisë.

Komisioni për dhënien e provimit profesional dhe kontrollin e njohurisë për inspektor

Neni 20

(1) Për realizimin e provimit profesional dhe provimit për kontroll të njohurisë për inspektor, ministri i Drejtësisë formon komision për dhënien e provimit profesional dhe kontrollin e njohurive për inspektor (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) për çdo sferë përkatëse të mbikëqyrjes inspektuese, me propozim të drejtorit ose funksionarit i cili udhëheq organin e administratës shtetërore.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, është i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë.

(3) Kryetari dhe dy anëtarë të komisionit zgjidhen nga radhët e nëpunësve shtetërorë udhëheqës nga shërbimi inspektues në sferën përkatëse, një anëtar nga Agjencia për Nëpunës Shtetërorë dhe një anëtar nga Ministria e Drejtësisë.

(4) Komisioni për realizimin e provimit profesional dhe provimit për kontroll të njohurive për inspektor, në afat prej pesë ditësh publikisht i shpall rezultatet.

(5) Ministria e Drejtësisë inspektorit i cili e ka dhënë provimin profesional përkatësisht për kontroll të njohurive për inspektor, i lëshon certifikatë për provim të dhënë profesional përkatësisht certifikatë për provimin e dhënë për kontroll të njohurisë për inspektor.

(6) Formularin, formën dhe përmbajtjen e certifikatës për provimin e dhënë profesional, përkatësisht për provimin e dhënë për kontroll të njohurive për inspektor, i përcakton ministri i Drejtësisë.

Provimi për kontroll të njohurisë për inspektor

Neni 21

(1) Për kontrollin e njohurisë, ndjekjes së vazhdueshme të gjendjes në legjislacion, si dhe të kualitetit dhe profesionalizmit gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, në çdo katër vjet nga dita e lëshimit të certifikatës për provim të dhënë profesional për inspektor, inspektori jep provim për kontroll të njohurisë për inspektor.

(2) Provimi për kontroll të njohurisë për inspektor, realizohet përmes dhënies së provimit në pajtueshmëri me programin për provim për kontroll të njohurisë për inspektor, që me propozimin e drejtorit e miraton ministri, përkatësisht funksionari i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, përkatësisht kryetari i komunës.

(3) Mënyrën e dhënies së provimit për kontroll të njohurive për inspektor, e përcakton ministri i Drejtësisë.

(4) Provimi nga paragrafi (1) i këtij neni, realizohet para Komisionit nga neni 20 paragrafi (1) i këtij ligji.

(5) Nëse inspektori nuk e jep provimin nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej 3 muajsh nga dita e dhënies së provimit, ka të drejtë në provim të përsëritur të të njëjtit.

(6) Inspektori i cili gjatë provimit të përsëritur nuk do ta japë provimin nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të sistematizohet që të kryejë detyra tjera pune të cilat i përgjigjen përgatitjes së tij profesionale.

(7) Nëse në pajtueshmëri me Aktin për sistematizim të vendeve të punës, inspektori nuk mund të sistematizohet që të kryejë detyra tjera pune të cilat i përgjigjen përgatitjes së tij profesionale, marrëdhënia e punës i ndërpritet.

Statusi i inspektorit

Neni 22

(1) Inspektori është me titull:

- inspektor më i ri,
- inspektor,
- inspektor i lartë,
- inspektor kryesor dhe
- inspektor i përgjithshëm.

(2) Inspektor më i ri mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin bashkëpunëtor nga Ligji për nëpunës shtetërorë.

(3) Inspektor mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin këshilltar nga Ligji për nëpunës shtetërorë.

(4) Inspektor i lartë mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin udhëheqës i seksionit nga Ligji për nëpunës shtetërorë.

(5) Inspektor kryesor mund të jetë nëpunësi i cili i plotëson kushtet për titullin udhëheqës i sektorit nga Ligji për nëpunës shtetërorë.

(6) Inspektor i përgjithshëm mund të jetë nëpunës i cili i plotëson kushtet për titullin këshilltar shtetëror nga Ligji për nëpunës shtetërorë.

V. TË DREJTAT, OBLIGIMET DHE AUTORIZIMET E INSPEKTORËVE

Obligimet e inspektorit

Neni 23

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, në pajtueshmëri me ligjin inspektori obligohet që:

1) të veprojë sipas iniciativës për ngritje të procedurës inspektuese dhe për këtë ta informojë parashtruesin e iniciativës;

2) ta lajmërojë personin përgjegjës të subjektit të mbikëqyrjes për fillimin e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ose nëse me njoftimin e tillë do të zvogëlohet efikasiteti i mbikëqyrjes, ose për mbrojtje të interesit të përgjithshëm, jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe pronës;

3) të legjitimohet para subjektit të mbikëqyrjes, përkatësisht para personit përgjegjës ose personit tjetër të autorizuar të subjekti të mbikëqyrjes;

4) të përpilojë procesverbal për mbikëqyrjen inspektuese të kryer;

5) ta ruajë fshehtësinë e të dhënave të klasifikuara;

6) të veprojë sipas ligjit, me kohë dhe në pajtueshmëri me Kodeksin etik të nëpunësve shtetërorë dhe Kodeksin etik të shërbimit inspektues dhe

7) ta lajmërojë personin përgjegjës të subjektit të mbikëqyrjes për bazën ligjore për kryerje të mbikëqyrjes.

Autorizimet e inspektorit

Neni 24

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori është i autorizuar që:

1) të kontrollojë akte të përgjithshme dhe të veçanta, skeda, dokumente, dëshmi dhe informata në sasi sipas lëndës së mbikëqyrjes inspektuese, si dhe të kërkojë nga subjekti i mbikëqyrjes ose punonjësit e tij të autorizuar që të përgatisin dokumente dhe kopje të nevojshme të përpunuara në gjuhë të huaja, të përkthehen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e tij cirilik dhe të verifikohen nga përkthyes i autorizuar gjyqësor;

2) të kryejë mbikëqyrje në hapësirat punuese dhe objekte të tjera që nuk shfrytëzohen si vendbanime, të mjeteve transportuese dhe prodhimeve;

3) të kontrollojë dokumente identifikimi të personave për shkak të vërtetimit të identitetit të tyre në pajtueshmëri me ligjin;

4) të kërkojë nga subjekti i mbikëqyrjes ose nga punonjësit e tij, sqarim me shkrim ose me gojë në lidhje me çështjet nga fushëveprimi i mbikëqyrjes inspektuese;

5) të kërkojë nga subjekti i mbikëqyrjes ose nga punonjësit e tij që të dorëzojnë të dhëna për furnizuesit e tyre me të cilat disponojnë;

6) të kërkojë mendim profesional kur ai është i nevojshëm për mbikëqyrjen inspektuese;

7) të marrë ekzemplarë pa kompensim për teste të mëtutjeshme ose kontrole në raste të përcaktuara me ligj ose me dispozitë tjetër;

8) të kontrollojë aktivitetet e subjektit të mbikëqyrjes gjatë shitjes së prodhimeve ose dhënies së shërbimeve;

9) të sigurojë audio dhe video incizime të cilat mund të shfrytëzohen në mbikëqyrjen inspektuese;

10) të kryejë regjistrim të mallrave të gjetura në hapësirën punuese, dhe

11) të sigurojë dëshmi të tjera të nevojshme.

(2) Nëse është nevojë e arsyeshme që të konfiskohen ose përkohësisht të ruhen prodhimet, dosjet ose dokumentet, inspektori në pajtueshmëri me ligjin mund:

1) të kërkojë nga subjekti i mbikëqyrjes ose nga punonjësi i tij që ka autorizime për këtë, të hap dhe të lejojë qasje në cilëndo hapësirë, enë të mbyllur, makinë ose mjete dhe

2) të kërkojë nga cilido person i cili ka autorizim për këtë, të sigurojë qasje në cilëndo dosje duke përfshirë edhe dosjet kompjuterike, hapësirat, enë të mbyllur ose makinë.

(3) Autenticitetin e kopjes me origjinalin e skedës, dokumentet, provat dhe informatat, i vërteton subjekti i mbikëqyrjes me vulë dhe nënshkrim të tij, ose punonjësi i tij me nënshkrim.

(4) Inspektori është i autorizuar që të ngrejë dhe të udhëheqë procedurë për barazim, ndërmjetësim, mediacion dhe procedurë për kundërvajtje në pajtueshmëri me ligjin.

Të drejtat dhe obligimet për mënjanimin e parregullsive

Neni 25

(1) Në pajtim me ligjin, për mënjanimin e parregullsive të konstatuara, inspektori ka të drejtë dhe obligim që subjektit të mbikëqyrjes:

- 1) t'i tregojë për parregullsitë e konstatuara dhe të përcaktojë afat për mënjanimin e tyre;
- 2) t'i urdhërojë të ndërmerë masa dhe aktivitete përkatëse në afatin të cilin do ta përcaktojë inspektori;
- 3) përkohësisht t'ia ndalojë kryerjen e veprimtarisë, profesionit ose detyrës;
- 4) përkohësisht t'i konfiskojë sende dhe mjete me të cilat është kryer vepër penale ose kundërvajtje, në pajtueshmëri me ligjin;
- 5) t'i parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje dhe
- 6) t'i ngritë padi penale ose të ngritë ndonjë tjetër procedurë përkatëse.

(2) Për mënjanimin e mangësive të konstatuara, inspektori mund të kryejë edhe autorizime dhe përgjegjësi tjera në pajtueshmëri me ligjin.

Njoftimi i organit kompetent

Neni 26

(1) Nëse në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese inspektori konstaton parregullsi për mënjanimin e të cilave nuk është kompetent, me procesverbal i konstaton dhe e njofton organin kompetent.

(2) Inspektori pas kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese mund të konsultohet me subjektin e mbikëqyrjes, për mënjanim më efikas të parregullsive të konstatuara.

VI. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E SUBJEKTIT TË MBIKËQYRJES

Obligimi i përgjithshëm i subjektit të mbikëqyrjes

Neni 27

Subjekti i mbikëqyrjes është i obliguar që të veprojë sipas kërkesës, përkatësisht sipas urdhrin të inspektorit.

Obligimi i subjektit të mbikëqyrjes në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese

Neni 28

(1) Subjekti i mbikëqyrjes është i obliguar që inspektorit t'i mundësojë kryerje të papenguar të mbikëqyrjes inspektuese, të vë nën inspektim dokumente dhe të dhëna të cilat janë të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes.

(2) Subjekti i mbikëqyrjes është i obliguar që inspektorit t'i sigurojë kushte të nevojshme për kryerjen e punës pa penguar dhe përcaktimin e situatës faktike.

(3) Subjekti i mbikëqyrjes është i obliguar që inspektorit t'i mundësojë në afatin e përcaktuar qasje në hapësirat, prodhimet, dokumentet ose çfarëdo lloj mjeti i cili është lëndë e mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Subjekti i mbikëqyrjes të i cili kryhet mbikëqyrja inspektuese është i obliguar që pas kërkesës me shkrim t'inspektorit, ta ndërpresë punën gjatë kohës së mbikëqyrjes inspektuese, nëse inspektori në mënyrë tjetër nuk mund ta kryejë mbikëqyrjen dhe ta përcaktojë situatën faktike.

(5) Inspektori mund të kërkojë nga subjekti i mbikëqyrjes që të kryejë ndonjë aktivitet në procedurën inspektuese, për shkak të përcaktimit të plotë të situatës faktike dhe të përcaktojë afat për kryerjen e atij aktiviteti.

(6) Subjekti i mbikëqyrjes është i obliguar që me kërkesë me shkrim të inspektorit, në afatin e përcaktuar me kërkesë, inspektorit t'i dorëzojë ose përgatitë të dhëna, raporte, materiale të sakta dhe të plota ose dokumente tjera të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese.

Të drejtat e subjektit të mbikëqyrjes në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese

Neni 29

(1) Subjekti i mbikëqyrjes ka të drejtë të japë deklarata në procesverbal dhe vërejtje lidhur me ligjshmërinë e procedurës së mbikëqyrjes inspektuese, raportin e inspektorit ose vërtetësinë e situatës faktike të përcaktuar, me arsyetim për shkaqet e këtë.

(2) Subjekti i mbikëqyrjes ka të drejtë që të refuzojë ta nënshkruajë procesverbalin, nëse nuk pajtohet me faktet të cilat janë të paraqitura në procesverbal, ose nëse i është pamundësuar e drejta nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Refuzimi për ta nënshkruar procesverbalin, nuk e pengon udhëheqjen e mëtejshme të procedurës së mbikëqyrjes inspektuese.

Personat përgjegjës në procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes

Neni 30

(1) Për kryerjen e papenguar të mbikëqyrjes inspektuese, si dhe për zbatimin e masave të shqiptuara, përgjigjet subjekti i mbikëqyrjes dhe personi përgjegjës në subjektin e mbikëqyrjes.

(2) Subjekti i mbikëqyrjes, përkatësisht personi përgjegjës në subjektin e mbikëqyrjes është i obliguar që menjëherë pas kalimit të afatit të përcaktuar për zbatimin e masës inspektuese, kurse më së voni në afat prej tri ditësh, me shkrim ta njoftojë inspektorin nëse janë zbatuar masat inspektuese të urdhëruara.

Obligimet për personat tjerë

Neni 31

(1) Personi i cili nuk është subjekt i mbikëqyrjes në procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, është i obliguar që të mundësojë kryerje të kontrollit inspektues, kur ekziston dyshim i bazuar se në hapësirat dhe objektet e tij, kryhet veprimtari ose gjenden sende të cilat janë të lidhura me mbikëqyrjen inspektuese.

(2) Nëse personi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk lejon kryerjen e kontrollit inspektues, ndaj tij do të zbatohen autorizime të cilat inspektorin i ka si ndaj subjektit të mbikëqyrjes.

VII. PROCEDURA E KRYERJES SË MBIKËQYRJES INSPEKTUESE

Llojet e mbikëqyrjes inspektuese

Neni 32

(1) Nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe, mbikëqyrjen inspektuese inspektorin e kryen përmes:

- mbikëqyrjes së rregullt inspektuese,
- mbikëqyrjes së jashtëzakonshme inspektuese dhe
- mbikëqyrjes inspektuese kontrolluese.

(2) Mbikëqyrja e rregullt inspektuese është mbikëqyrje e paralajmëruar e cila kryhet në bazë të programit për punë të shërbimeve inspektuese dhe përfshin mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe dispozitave të miratuara në bazë të ligjeve.

(3) Mbikëqyrja e jashtëzakonshme inspektuese është mbikëqyrje e paparalajmëruar dhe kryhet mbi bazë të iniciativës së parashtruar nga organet shtetërore, personat fizikë ose juridikë, si dhe në rast të dyshimit të inspektorit (me detyrë zyrtare).

(4) Mbikëqyrja inspektuese kontrolluese kryhet pas kalimit të afatit të përcaktuar në aktin inspektues të miratuar nga ana e inspektorit, me ç'rast inspektorin gjatë përcaktimit të situatës faktike, do të konstatojë se subjekti i mbikëqyrjes:

- ka vepruar sipas aktit inspektues në tërësi,
- ka vepruar pjesërisht sipas aktit inspektues, ose

- nuk ka vepruar sipas aktit inspektues.

(5) Mosveprimi, përkatësisht veprimi i pjesërishëm sipas aktit inspektues, paraqet bazë për zbatimin e masave inspektuese në pajtueshmëri me ligjin.

Kryerja e mbikëqyrjes pa praninë e subjekteve të mbikëqyrjes

Neni 33

(1) Nëse inspektori në ditën kur e ka paralajmëruar mbikëqyrjen inspektuese, nuk e gjen personin përgjegjës të subjekti i mbikëqyrjes ose të personi fizik tek i cili është e nevojshme të kryhet mbikëqyrje inspektuese, inspektori në vendin e mbikëqyrjes do t'i lë ftesë që në kohë të caktuar të jetë i pranishëm për shkak të kryerjes së mbikëqyrjes.

(2) Dëmtimi, shkatërrimi ose mënjanimi i mëvonshëm i ftesës nuk ndikon në rregullshmërinë e dorëzimit

(3) Nëse personi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk i përgjigjet ftesës, inspektori do të kryejë mbikëqyrje në prani të personit zyrtar ose personit tjetër.

Pengimi i inspektorit

Neni 34

(1) Inspektori do ta paralajmërojë ose do ta largojë personin i cili e pengon kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Nëse inspektori vlerëson se mbikëqyrja inspektuese nuk mund të kryhet as me ndërmarrjen e masave nga paragrafi (1) i këtij neni, do të kërkojë ndihmë nga organi i administratës shtetërore në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me ligj.

Bashkëpunimi me organet e administratës shtetërore ose me personin juridik

Neni 35

(1) Inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ka të drejtë nga organet e administratës shtetërore ose personi juridik i cili mban regjistër, të kërkojë të dhëna, si dhe ndihmë nga organet e administratës shtetërore për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të obliguar që të bashkëpunojnë me inspektorin.

Bashkëpunimi me institucionet tjera

Neni 36

Inspektori mundet në kuadër të procedurës inspektuese, të kërkojë mendim dhe bashkëpunim nga institucionet profesionale, nëse kjo është e nevojshme për përcaktim dhe vlerësim të drejtë të gjendjes faktike.

Procesverbali

Neni 37

(1) Për mbikëqyrjen e kryer inspektuese, inspektori sipas rregullës përgatit procesverbal në vendin e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Inspektori dhe subjekti i mbikëqyrjes inspektuese e nënshkruajnë procesverbalin pas kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese. Subjektit të mbikëqyrjes i dorëzohet ekzemplar nga procesverbali.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, kur për shkak të vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjes inspektuese, natyrës së saj dhe rrethanave nuk është e mundur që të përgatitet procesverbali gjatë mbikëqyrjes inspektuese, procesverbali përgatitet në hapësirat zyrtare të shërbimit inspektues në afat prej tri ditësh nga dita e mbikëqyrjes me arsyetim për arsyet për këtë.

(4) Ekzemplari nga procesverbali nga paragrafi (3) i këtij neni, i dorëzohet për nënshkrim subjektit të mbikëqyrjes. Nëse subjekti i mbikëqyrjes në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të procesverbalit nuk prononcohet në lidhje me procesverbalin e dorëzuar, ose nuk ia kthen të nënshkruar inspektorit, konsiderohet se subjekti i mbikëqyrjes është pajtuar me procesverbalin nga mbikëqyrja e kryer inspektuese.

(5) Nëse subjekti i mbikëqyrjes refuzon ta nënshkruajë procesverbalin, inspektori do t'i theksojë arsyet për refuzimin.

(6) Në procesverbal shënohet emri i shërbimit inspektues i cili e kryen mbikëqyrjen, vendi, dita dhe ora kur kryhet mbikëqyrja, lënda e mbikëqyrjes, emrat e inspektorëve, të personave të pranishëm dhe të përfaqësuesve të tyre dhe të autorizuarit.

(7) Procesverbali doemos duhet të hartohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

(8) Procesverbali duhet të përmbajë pasqyrim për gjendjen faktike të konstatuar gjatë mbikëqyrjes inspektuese.

(9) Formën dhe elementet obliguese të procesverbalit nga mbikëqyrja e kryer inspektuese, i përcakton ministri i Drejtësisë.

Konstatimi i fakteve gjatë procedurës

Neni 38

Në procesverbalin për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese konstatohen vërejtjet, deklaratat dhe rrethanat dhe faktet tjera relevante.

Mbikëqyrje inspektuese te subjektet e panjohura

Neni 39

(1) Në rastet kur inspektori nuk mund të përcaktojë se cili është subjekti i mbikëqyrjes në procedurë, inspektori në vendin e mbikëqyrjes do t'i dorëzojë ftesë subjektit të panjohur të mbikëqyrjes që në ditën dhe orën e caktuar të jetë i pranishëm në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Nëse subjekti i panjohur i mbikëqyrjes nuk i përgjigjet ftesës nga paragrafi (1) të këtij neni, mbikëqyrja inspektuese do të kryhet pa praninë e subjektit të mbikëqyrjes në prani të personit zyrtar ose personit tjetër.

Konkluzioni dhe aktvendimi

Neni 40

(1) Në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese inspektori miraton konkluzion dhe aktvendim.

(2) Formën dhe elementet e obligueshme të konkluzionit dhe aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri i Drejtësisë.

Konkluzioni

Neni 41

(1) Me konkluzion vendoset për çështjet e procedurës që do të paraqiten gjatë mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Konkluzion me shkrim miratohet vetëm në rastet kur për konkluzionin lejohet ankesë.

(3) Konkluzioni nga paragrafi (2) i këtij neni, nuk miratohet nëse subjekti i mbikëqyrjes tërhiqet nga e drejta e ankesës në procesverbal.

(4) Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese nuk konstatohen mangësi apo mangësitë e konstatuara janë mënjeluar gjatë mbikëqyrjes inspektuese, përkatësisht deri në miratimin e konkluzionit nga paragrafi (2) i këtij neni, inspektori për këtë është i obliguar që të miratojë konkluzion për ndërprerjen e procedurës.

(5) Kundër konkluzionit nga paragrafi (4) i këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë në ankesë ose lloj tjetër të mbrojtjes juridike në pajtueshmëri me ligj.

Aktvendimi

Neni 42

(1) Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese konstaton se është shkelur ligji ose rregull tjetër, me procesverbal i konstaton parregullsitë e konfirmuara dhe me vendim e përcakton afatin në të cilin mangësia duhet të mënjanohet.

(2) Nëse me ligj është e paraparë që për parregullsinë e konstatuar mund të përcaktohet masë inspektuese, inspektori është i obliguar që me aktvendim ta përcaktojë atë masë.

(3) Inspektori aktvendimin nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, në bazë të fakteve të konstatuara me mbikëqyrjen, do ta miratojë pa prolongim, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditësh nga përfundimi i mbikëqyrjes, nëse me ligj nuk është përcaktuar afat më i shkurtër.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori mund të shqiptojë masa inspektuese me vendim gojor në procesverbal, kur do të vlerësojë se kjo është e domosdoshme për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë të jetës dhe shëndetit të njerëzve, pronës me vlerë më të madhe, ose kur është në pyetje mbrojtja e llojit tjetër të interesit publik.

(5) Në rastin nga paragrafi (4) i këtij neni, inspektori është i obliguar që në afat prej tri ditësh nga dita e shqiptimit të vendimit gojor të miratojë aktvendim me shkrim.

Mjeti juridik

Neni 43

(1) Kundër aktvendimit të inspektorit mund të parashtrohet ankesë, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, nëse me ligj nuk është paraparë afat më i shkurtër.

(2) Për ankesën kundër vendimeve të inspektorit në inspektorat vendos komision i veçantë në ministri, i përbërë prej tre anëtarëve të cilët i emëron ministri.

(3) Për ankesën kundër aktvendimeve të inspektorit në njësinë organizative të organizuar si shërbim inspektues në organet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetadministrimit lokal dhe qytetit të Shkupit, vendos komisioni i veçantë prej tre anëtarëve të emëruar nga ministri, funksionari i organit të administratës shtetërore, përkatësisht kryetari i komunës.

(4) Komisionet nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, vendimin për ankesën do ta miratojnë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

Shpallja e akteve inspektuese

Neni 44

Shërbimet inspektuese i shpallin aktet inspektuese në ueb faqen e tyre në afat prej tre ditësh nga dita e miratimit të akteve nga neni 40 të këtij ligji, në pajtueshmëri me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Legjitimacioni zyrtar

Neni 45

(1) Inspektori ka legjitimacion zyrtar me të cilin e dëshmon cilësinë e tij, identitetin dhe autorizimet.

(2) Formën dhe përmbajtjen e formularëve të legjitimacionit, dukjen e shenjës me propozimin e drejtorit, i përcakton ministri i cili i udhëheq Ministrinë në përbërjen e së cilës është inspektorati, ndërsa për inspektorin nga njësinë organizative e organizuar si shërbim inspektues, i përcakton funksionari i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, përkatësisht kryetari i komunës.

VIII. VEPRIME TË VEÇANTA NË PROCEDURËN INSPEKTUESE

Marrja e ekzemplarit

Neni 46

Në pajtueshmëri me ligjin inspektori mund të marrë ekzemplar, nëse në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese është e nevojshme që të vërtetohet nëse produktet në prodhimtari ose në shitje përputhen me përbërjen e përcaktuar, përkatësisht kualitetin.

Procedura për marrjen e ekzemplarit

Neni 47

Gjatë marrjes së ekzemplarit inspektori është i obliguar, që:

1) në kushte të njëjta në kohë të njëjtë të merr më së shumti tre ekzemplarë në sasi të nevojshme për analizë (për analizë të parë, për analizë të dytë me kërkesë të subjektit të mbikëqyrjes dhe për superanalizë);

2) të përgatisë procesverbal për marrjen e ekzemplarit;

3) t'i vulosë ekzemplarët dhe t'i shënojë sipas rregullës;

4) ta dorëzojë pa prolongim ekzemplarën për analizën e parë në institucionet profesionale për ekspertizë, kurse ekzemplarën e dytë dhe të tretë t'i ruajë në kushte adekuate;

5) ta lajmërojë me shkrim dhe pa prolongim subjektin e mbikëqyrjes për rezultatet e analizës;

6) ta dorëzojë pa prolongim ekzemplarën e dytë në analizë në institucionin tjetër profesional me kërkesë të subjektit të mbikëqyrjes dhe

7) ta përcaktojë me konkluzion të veçantë shumën e shpenzimeve që janë krijuar gjatë procedurës në lidhje me analizën e ekzemplarëve, në rast kur ekzemplari nuk përputhet me standardet e përcaktuara.

Parakushti për përputhshmëri

Neni 48

Nëse subjekti i mbikëqyrjes gjatë marrjes së ekzemplarit për analizë nuk kërkon njëkohësisht marrje të ekzemplarit për analizën e dytë, nuk mund t'i kontestojë rezultatet nga analiza e marrë.

Kontestimi i rezultateve nga analiza

Neni 49

(1) Subjekti i mbikëqyrjes mund t'i kontestojë rezultatet nga analiza e ekzemplarit të parë me kërkesë për kryerje të analizës së ekzemplarit të dytë (të marrë në kohë dhe mënyrë të njëjtë), në afat prej tri ditësh nga dita e dorëzimit të rezultateve nga analiza e ekzemplarit të parë.

(2) Supozohet se subjekti i mbikëqyrjes është pajtuar me rezultatet nga analiza e ekzemplarit të parë, nëse kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e dorëzon në afatin e përcaktuar.

(3) Nëse rezultatet nga analiza e ekzemplarit të dytë nuk janë në pajtueshmëri me rezultatet nga analiza e ekzemplarit të parë, juridikisht valide do të konsiderohet analiza e dytë.

(4) Analiza e ekzemplarit të dytë nuk mund t'i ngarkohet institucionit profesional i cili e ka kryer analizën e ekzemplarit të parë.

Superanaliza

Neni 50

(1) Nëse inspektori nuk pajtohet me rezultatet nga analiza e ekzemplarit të dytë, mundet në afat prej tre ditëve nga pranimi i këtyre rezultateve të kërkojë kryerjen e superanalizës, përveç nëse rezultatet nga analiza e ekzemplarit të parë edhe të dytë nuk janë të njëjta.

(2) Superanalizën nuk mund ta kryejë institucion profesional i cili i ka kryer analizat e mëparshme, vetëm nëse nuk ka institucione tjera për kryerjen e atyre analizave dhe nëse inspektori dhe subjekti i mbikëqyrjes pajtohen që analiza t'i ngarkohet njërit nga institucionet i cili tanimë ka kryer analizë.

Shpenzimet nga analiza

Neni 51

(1) Shpenzimet nga analiza do t'i bart subjekti i mbikëqyrjes, nëse konstatohet se ekzemplarët e marrë nuk i përgjigjen standardeve të përcaktuara.

(2) Shpenzimet nga analiza do t'i bart shërbimi inspektues kompetent, nëse vërtetohet se ekzemplarët i përgjigjen standardeve të përcaktuara.

Konfiskimi i përkohshëm i sendeve për shkak të sigurimit të dëshmive

Neni 52

(1) Inspektori mundet në suaza të kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, përkohësisht të konfiskojë dokumente, mallra dhe sende tjera të cilat mund të shfrytëzohen si dëshmi në procedurën përkatëse.

(2) Konfiskimi i sendeve nga paragrafi (1) i këtij neni, zgjat deri në miratimin e vendimit të plotfuqishëm në procedurë.

Konfiskimi i detyrueshëm i sendeve

Neni 53

Inspektori është i obliguar që përkohësisht të konfiskojë sende, kur është përcaktuar konfiskimi i tyre i detyrueshëm, kur me to është kryer kundërvajtje ose vepër penale, ose nëse kjo është e nevojshme për parandalimin e pasojave më të rënda, në pajtueshmëri me ligjin.

Dhënia e detyrueshme e vërtetimit për sendet dhe shkresat e konfiskuara përkohësisht

Neni 54

(1) Inspektori i jep vërtetim subjektit të mbikëqyrjes nga i cili përkohësisht konfiskohen sende dhe shkresa.

(2) Vërtetimi nga paragrafi (2) i këtij neni përmban të dhëna për emrin dhe mbiemrin, përkatësisht emrin e subjektit të mbikëqyrjes, kohën dhe vendin e konfiskimit të sendeve dhe shkresave, bazën juridike për konfiskimin e sendeve dhe shkresave, shënimin e saktë të sendeve dhe shkresave të konfiskuara sipas llojit, sasisë, nënshkrimit e personit përgjegjës të subjektit të mbikëqyrjes dhe të dhëna tjera të nevojshme për identifikimin e sendeve dhe shkresave të konfiskuara dhe nënshkrimit, emrin dhe mbiemrin e inspektorit.

Detyrimi për dorëzimin e sendeve të konfiskuara organeve kompetente

Neni 55

(1) Sendet ose mallrat e konfiskuara përkohësisht, me kërkesë përkatëse për ngritje të procedurës, inspektori i dorëzon në organin kompetent gjyqësor për kundërvajtje ose në organin tjetër.

(2) Kërkesën për ngritje të procedurës nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori e dorëzon në afat prej 48 orëve nga ora e konfiskimit të përkohshëm.

(3) Organi kompetent gjyqësor për kundërvajtje dhe organi tjetër është i obliguar që në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni të vendos me procedurë urgjente.

Sigurimi i kushteve për konfiskimin e përkohshëm të sendeve

Neni 56

(1) Shërbimi inspektues kompetent është i obliguar që të sigurojë kushte për ruajtjen e sendeve të konfiskuara përkohësisht ose gjësë së gjallë, deri në dorëzimin e tyre organit kompetent për udhëheqjen e procedurës përkatëse, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Organi kompetent për udhëheqjen e procedurës penale ose për kundërvajtje, me sendet e konfiskuara përkohësisht vepron në pajtim me ligjin.

Ndalimi i përkohshëm i kryerjes së veprimtarisë

Neni 57

(1) Kur organi inspektues do të konstatojë parregullsi në masë më të madhe ose parregullsi që e rrezikojnë jetën apo shëndetin e njerëzve ose mjedisin jetësor dhe në raste tjera të përcaktuara me ligj, inspektori përkohësisht do të ndalojë kryerjen e veprimtarisë me vulosjen e hapësirave, objekteve, kantierëve, pajisjeve, mjeteve të punës dhe mjeteve tjera, deri në mënjanimin e parregullsive.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori do t'i detyrojë personat juridikë të cilët kryejnë shërbime publike (furnizim me ujë, me rrymë elektrike dhe të ngjashme) ta ndërprejnë dërgimin, përkatësisht dhënien e kushteve të përshtatshme subjektivit të mbikëqyrjes, të domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së tij.

(3) Personi juridik nga paragrafi (2) i këtij neni, është i obliguar që të veprojë sipas urdhrorit të inspektorit.

IX. MARRËDHËNIET E SHËRBIMEVE INSPEKTUESE DHE ORGANEVE KOMPETENTE

Procedura urgjente

Neni 58

(1) Procedura për kërkesat dhe kallëzimet e inspektorëve është urgjente.

(2) Organi kompetent është i obliguar që menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit, t'i marrë në shqyrtim kërkesën dhe kallëzimet e inspektorëve, nëse nuk është përcaktuar afat më i shkurtër me këtë ose me ligj tjetër.

Detyrimi për njoftim për rezultatet nga procedura

Neni 59

Organi te i cili është parashtruar kallëzimi penal, kërkesa për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ose kërkesa për ngritjen e procedurës tjetër përkatëse, është i obliguar që për rezultatet nga procedura ta njoftojë shërbimin inspektues kompetent.

X. SHPENZIMET NGA PROCEDURA INSPEKTUESE

Shpenzimet e procedurës

Neni 60

(1) Shpenzimet nga procedura inspektuese e cila është kryer pa shqiptimin e masës inspektuese i bart shërbimi inspektues, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Shpenzimet nga procedura inspektuese e cila është kryer me shqiptimin e masës inspektuese i bart subjekti i mbikëqyrjes, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Për shpenzimet e procedurës të cilat janë të njohura në momentin e miratimit të aktvendimit vendoset në vet aktvendimin, ndërsa nëse shpenzimet nuk janë të njohura në këtë moment, vendoset me konkluzion të veçantë.

XI. KRYERJA E PËRBASHKËT E MBIKËQYRJES INSPEKTUESE

Mbikëqyrje e koordinuar inspektuese nga më shumë shërbime inspektuese

Neni 61

(1) Mbikëqyrje inspektuese mund të kryhet njëkohësisht, nga ana e më shumë shërbimeve inspektuese.

(2) Mbikëqyrje e përbashkët inspektuese detyrimisht kryhet, nëse:

1) kjo është e domosdoshme për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë të jetës dhe shëndetit të njerëzve, ose pronës me vlerë më të madhe;

2) kjo është e domosdoshme për ndërmarrjen e masave të cilat nuk durojnë prolongim;

3) kjo është e domosdoshme për shkak të ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjes ose të rëndësisë së mënjanimin të mangësive;

4) kjo është e domosdoshme për kontroll të objekteve me rëndësi të veçantë për turizmin, tregtinë, hotelerinë, trafikun dhe të tjera, për marrjen e ekzemplarit nga malli ose sendet tjera, kontrolli i të cilave është në kompetencë të më shumë inspeksioneve;

- 5) vlerësohet se mbikëqyrja në këtë mënyrë mund të kryhet më shpejt dhe me më pak shpenzime dhe humbje të kohës të subjektit të mbikëqyrjes dhe të inspektorëve;
- 6) kjo është e domosdoshme për shqyrtimin e provave në iniciativë ose ankesë, ndërsa kjo është në kompetencë të dy ose më shumë organeve të administratës shtetërore dhe
- 7) në raste tjera të përcaktuara me ligj.

Bashkëpunimi i shërbimeve inspektuese në kryerjen e mbikëqyrjes së përbashkët

Neni 62

Për shkak të kryerjes së mbikëqyrjes së përbashkët, shërbimet inspektuese janë të obliguara veçanërisht:

- 1) t'i harmonizojnë programet dhe planet për punë dhe ta planifikojnë kryerjen e përbashkët të mbikëqyrjes;
- 2) të shkëmbejnë përvoja dhe t'i unifikojnë qëndrimet për mënyrën dhe metodat e punës dhe çështje tjera;
- 3) të mbajnë mbledhje, konsultime, këshillime të përbashkëta dhe forma tjera të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe
- 4) t'i lajmërojnë organet tjera shtetërore për zbatimin e rregullave në kompetencë të tyre, për të cilat do të kuptojnë në kryerjen e mbikëqyrjes.

XII. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 63

(1) Gjobë në shumë prej 2 000 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- 1) nuk vepron sipas kërkesës, përkatësisht sipas urdhrit të inspektorit (neni 27);
- 2) inspektorit nuk i mundëson kryerje të papengueshme të mbikëqyrjes (neni 28 paragrafi (1));
- 3) inspektorit nuk i mundëson në afatin e caktuar qasje në hapësirat, prodhimet, dokumentet ose çdo mjeti tjetër i cili është objekt i mbikëqyrjes inspektuese (neni 28 paragrafi (3)) ose
- 4) nëse inspektorit në afatin e caktuar me kërkesë nuk i dorëzohen ose përgatit të dhëna, raporte, materiale të sakta dhe të plota ose dokumente tjera të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese (neni 28 paragrafi (6)).

(2) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës te personi juridik për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik, për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 64

Për kundërvajtjet nga neni 63 i këtij ligji, para parashtrimit të kërkesës për ngritje të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente, inspektori është i obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojë procedurë për barazim, në pajtueshmëri me Ligjin për kundërvajtje.

XIII. ZBATIMI I LIGJIT DHE MBIKËQYRJA

Zbatimi i ligjit dhe mbikëqyrja

Neni 65

(1) Për zbatimin e këtij ligji kujdeset organi i drejtorisë kompetente për punët e administratës shtetërore.

(2) Mbikëqyrje inspektuese ndaj zbatimit të rregullave të këtij ligji si dhe të dispozitave të miratuara në bazë të tij, kryen Inspektorati Shtetëror Administrativ.

XIV. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Konstituimi i Këshillit Inspektues

Neni 66

Këshilli Inspektues do të fillojë me punë në afat prej 30 ditësh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Zbatimi i Ligjit për procedurat e filluara

Neni 67

Procedurat inspektuese të filluara para ditës së fillimit të zbatimit të këtij ligj, do të kryhen sipas rregullave të cilat kanë vlejtur para ditës së fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Provimi për kontrollin e njohurisë për inspektor për inspektorët të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune deri në ditën e fillimit të zbatimit të ligjit

Neni 68

Inspektorët të cilët kanë themeluar marrëdhënie të rregullt pune para ditës së fillimit të zbatimit të këtij ligji, provimin për kontroll të njohurisë për inspektor nga neni 21 i këtij ligji, do ta japin në çdo katër vite duke llogaritur nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Harmonizimi i ligjeve

Neni 69

Ligjet me të cilat është rregulluar kompetenca e organeve nga neni 1 paragrafi (2) të këtij ligji, do të harmonizohen me dispozitat e këtij ligji deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Harmonizimi i akteve për organizimin e brendshëm dhe akteve për sistematizimin e vendeve të punës

Neni 70

Organet nga neni 1 paragrafi (2) të këtij ligji, aktet për organizimin e brendshëm dhe aktet për sistematizimin e vendeve të punës, t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Miratimi i akteve nënligjore

Neni 71

Organet nga neni 1 paragrafi (2) të këtij ligji, janë të obliguar që aktet nënligjore të parapara me këtë ligj t'i miratojnë deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Hyrja në fuqi

Neni 72

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 janari 2011.